

**LËNDA: PROGRAMI DHE FONDI I PYETJEVE PËR PROVIMIN E  
SHTETIT PËR NËNPROFESIONIN INSTRUMENTE MUZIKORË.**

**Tryeza e lëndës**

**1. Orjentim**

**2.Qëllimi**

**3. Përbajtja lëndore e programit**

**3.1 Historia e Muzikës Botërore**

**3.2 Teoria bazë muzikore**

**3.3 Format dhe strukturat e veprave muzikore.**

**4. Instrumetet muzikore**

**4.1 Instrumetet dhe formacionet e ndyshme të muzikës së dhomës**

**4.2 Instrumetet e orkestrës sinfonike.**

**4.3 Instrumetet tradicionale kombetarë.**

## **LËNDA: PROGRAMI DHE FONDI I PYETJEVE PËR PROVIMIN E SHTETIT PËR NËNPROFESIONIN INSTRUMENTE MUZIKORË.**

### **1. Orjentim**

Në hartimin e programit dhe përpilimin e pyetjeve është mbajtur parasysh aspekti historik i përvojave pedagogjike-profesionale nëpërmjet, metodave dhe metodikave të aplikuara në institucionet e arsimit të mesem e të lartë si dhe të institacioneve të artit në Republikën e Shqipërisë.

Programi mësimor përfshin studimet në teknikat analitike që mbulojnë të gjithë historinë e praktikës muzikor (metodologjite e studimeve të specializuara dhe qasjet teorike të caktuara si dhe metodologjite e përcaktuara historikisht)si studime të aplikuara në veprat muzikore; Theksi është vendosur mbi njohjen e teorisë bazë të muzikës dhe zhvillimin e aftësive interpretuese të saj (të kënduarit, vesh-trajnim, realizimi i muzikës, pjesë në instrument).

Gjithëashtu duke u mbështetur në kurrikulën e re dhe programet lëndore që kandidatët kanë absorbuar nëpërmjet shkollimit, testi i fondit të pyetjeve do të përfshij një prezantim të plotë të njohurive themelore teorike të artit dhe të përfaqësuesve më në zë të kësaj fushe.

### **2.Qëllimi**

Synimi themelor i këtij programi është që t'i aftësojë pjesëmarrësit me dijenitë se cilat janë etapat themelore të zvillimit stilistik,pedagogjik-muzikorë si dhe cilat janë zhanret,formacionet dhe teknologjia e kësaj fushe.

Vend të posaçëm në program zënë proceset bazë të zhvillimit historik muzikor të periudhës; (Barokë,,Klasikë,Romantikë,Impresionizmi, muzika e shekullit XX dhe ajo bashkëkohore) të cilat zbërthejnë kategoritë themelore të logjikës së të menduarit dhe të përceptuarit te kandidatëve.

### **3. Përbajtja lëndore e programit**

**3.1 Historia e Muzikës Botërore**, ka një trajtim të përqëndruar teorik të çështjeve kryesore muzikore në evolucionin e mendimit dhe të gjuhës muzikore e cila shprehet dhe në fushen e interpretimit dhe instrumentave muzikorë. Në këtë kuadër, duhet të studiohen dhe të njihen në mënyrë edhe më specifike përqasjet e ndryshme midis autorit, veprës dhe stilit.

Trajtimi teorik i çështjeve duhet të shoqërohet me studim teorik,dëgjime përkatëse muzikore dhe analiza të përgjithshme të tyre.



### Konkretisht

- a) Studimi i perjudhës **Baroke**. Veprat, instrumetet dhe kompozitoret perfaqesues te ksaj perjudhe muzikore.
- b) Studimi i perjudhës **Klasike**. Veprat vokalo-sinfonike, instrumetet dhe kompozitoret perfaqesues te ksaj perjudhe muzikore.
- c) Studimi i perjudhës **Romantike**. Veprat sinfonike, instrumetale, dhe kompozitoret perfaqesues te ksaj perjudhe muzikore.
- d) Kompozitorët përfaqesues të shekullit XX-të.

### 3.2 Teoria bazë muzikore

Teoria e muzikës, moduli "**Solfezh, Harmoni, Analize forme**" e cila tradicionalisht përqendrohet në studimin e elementeve simbolik të muzikës me të cilat kjo e fundit është e shkruar permban njohuri te rendesishme dhe te domosdoshme per zberthimin e ceshtjeve stilistike dhe teknike te veprave muzikore.

- a) Konceptet themelore të tilla si shkallët muzikore, çelësat, intervallet, ritëmi, etj  
 b) Dinamika muzikore dhe përdorimi i saj ne gjuhën Italjane dhe Angleze.

<i>piano</i>	soft	soft	<i>p</i>
<i>forte</i>	loud	loud	<i>f</i>
<i>mezzo-forte</i>	half loud	moderately loud	<i>mf</i>
<i>mezzo-piano</i>	half soft	moderately soft	<i>mp</i>
<i>pianissimo</i>	as soft as possible	very soft	<i>pp</i>
<i>fortissimo</i>	as loud as possible	very loud	<i>ff</i>
<i>forte piano</i>	loud soft	loud then immediately soft i.e. an accent	<i>fp</i>
<i>forzato</i> or <i>sforzato</i> or <i>sforzando</i>	forced/forcing	accent	<i>fz</i> or <i>sf</i> or <i>sz</i>
<i>rinforzando</i>	reinforcing	sudden accent	<i>rf</i> or <i>rfz</i> or <i>rinf</i>
<i>crescendo</i>	get louder	get louder	<i>cresc.</i> or 
<i>diminuendo</i> OR <i>decrescendo</i>	get softer	get softer	<i>dim.</i> or <i>decresc.</i> or 

c) Akordet muzikore, ndertimi dhe emertimi i tyre ne tonalitetet e ndryshme mazhore dhe minore.

Akordet muzikore janë një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të gjuhës muzikore. Kompozitorët i përdorin ato për të harmonizuar dhe zhvilluar konceptin melodik. Këtu ju mund të shihni se si Beethoven ka harmonizuar në një mënyrë shumë të thjeshtë melodinë Oda e Gëzimit (Ode to Joy). Disa akorde janë të përmbyshura.

Shëmbull

### **3.3 Format dhe strukturat e veprave muzikore.**

Çdo pjesë muzikore eshte e përbërë nga fraza ose seksione të organizuara qe ne tërsine e tyre paraqesin një forme muzikore të përcaktuar.

Njohurtë e mara në lëndën e analizës se formes ju udhezojne qe te percaktoni qarte formen e nje pjese ose vepre muzikore.

Si ka evoluar dhe si paraqitet në mënyre skematike forma muzikore?

Shëmbull

- **Kenge,Strofa----- AAA, etc.**
- **Dy pjesesh i thjeshte----- - AB**
- **Tre pjesesh i thjeshte ----- ABA**
- **Rondo ----- ABACA**
- **Forma e sonates – Paraqitja e temave: (Tema 1 - Tema 2) --- Zhvillim ---  
Permledhja: (Tema 1 - Tema 2)**

Ps.Germat kapitale anash forms muzikore jane perdorur për të dalluar përbërjen dhe ndryshimet e seksioneve.

Shëmbuj të zhanreve instrumentale:

- **Dance ----- Valle**
- **Fantasia ----- Fantazi**
- **Prelude ----- Prelud**
- **Toccata ----- Tokata**
- **Fugue ----- Fugë**

- **Sonata** ----- **Sonatë**
- **Suite**----- **Suite**
- **Concerto** ----- **Koncert**
- **Symphony**----- **Sinfoni**
- **Symphonic poem** ----- **Poemë simfonike**

Shëmbuj të zhanreve vokale:

- |                         |                       |
|-------------------------|-----------------------|
| • <b>Opera</b>          | <b>Opera</b>          |
| • <b>Solo cantata</b>   | <b>Kantatë vokale</b> |
| • <b>Madrigal</b>       | <b>Madrigal</b>       |
| • <b>Song</b>           | <b>Këngë</b>          |
| • <b>Romanza vocale</b> | <b>Romanza vocale</b> |

#### **4. Instrumetet muzikore**

##### **4.1 Instrumetet dhe formacionet e ndyshme të muzikës së dhomës**

Pothuajse të gjitha llojet e muzikës së dhomës kërkojë përdorimin e instrumenteve muzikore dhe në këtë mënyrë instrumentet janë pjesë themelore e formave të muzikës.

**Kuarteti i harqeve**,instrumentet më të përdorura në këtë ansambël janë violinë, violë, cello.

**Kuinteti i frymes** instrumentet më të përdorura në këtë ansambël janë

Flaut, oboe, klarinet, fagot, korno.

Në të dy këto formacion edhe instrumenti i pianos është i aktivizuar duke i dhene një kuptim ndryshe formacionit.

**Kuinteti i Tunxhit** instrumentet më të përdorura në këtë ansambël janë tromba, korno, tromboni, bas tuba.

Kompozitorë kanë shkruar muzikë për pothuajse çdo kombinim të mundshme të këtyre instrumenteve.

Teoritë e avancuara dhe praktikat e përdorura në muzikën e dhomës janë pjesë e studimit, të lëndës njojuri mbi instrumetet musikorë.

#### **4.2 Instrumetet e orkestrës sinfonike.**

Zhvillimi dhe pjesëmarja e instrumenteve muzikorë ne orkestrën sinfonike per gjatë pejudhave klasike, romantike dhe moderne.

#### **4.3 Instrumetet tradicional kombtarë.**

Njohri të instrumeteve muzikorë tradicional.

- a) Instrumentet kordofon
- b) Instrumetet ajrofon
- c) instrumetet membranofon

#### Programi i përbashkët për të gjitha nënprofesionet e Provimit të Shtetit në Mësuesi

#### **PROGRAMI I PËRGATITJES PEDAGOGJIKE PËR TË GJITHË MËSUESIT E RINJ**

<b>KOMPONENTËT E PROGRAMIT TË PEDAGOGJISË</b>	
<b>I</b>	<b>Kurikula e Arsimit Parauniversitar</b>
a.	<p><b>Temat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fusha e kurrikulës</li> <li>• Zhvillimi kurrikulës</li> <li>• Hartimi kurrikulës</li> <li>• Qëllimet, synimet dhe objektivat</li> <li>• Zbatimi kurrikulës</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Allan C. Orstein dhe Francis P. Hunkins “Kurikula, bazat, parimet dhe problemet” faqe 1-45, 285 - 467</p>
b.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet dhe programet mësimor</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Plani dhe programi mësimor i lëndës që secili mësues zbaton në praktikë</p>
c.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procesi i të nxënët</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Sula G. Kursi leksioneve 2011</p>

<b>II.</b>	<b>Metoda e mësimdhënies dhe mendimi kritik</b>	
<b>A</b>	<b>Literatura :</b> Temple, Craford et al “Strategji e mësimdhënies e të të nxënit në klasat mendimtare” 2006	
<b>B</b>	<b>Literatura:</b> Musai B “Metodologji e Mësimdhënies” 2003, Faqe 79-164	
<b>C</b>	<p><b>Temat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>“Planifikimi i mësimit</li> <li>“Metodat e mësimdhënies</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Grup Autorësh “ Metodat e mësimdhënies – ( Manual për mësuesit e rinj)” 1999 faqe 56 – 119</p>	
<b>D</b>	<b>Literatura:</b> Levis Vaughn dhe Chris Macdonald “Fuqia e të menduarit kritik” 2010	
<b>E</b>	<b>Literatura :</b> Jeff Zwiers “Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6 deri 12”, 2006.	
<b>III</b>	<b>Aftësitë ndërkurikulare</b>	
	<p><b>Temat :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi psikologjik i moshës shkollorë</li> <li>Përfshirja e prindërve në edukim</li> <li>Motivacioni dhe mësuesi</li> <li>Roli dhe shprehitë profesionale të mësuesit</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Tamo A. Karaj TH. Rapti E.” Mësimdhënia e të nxënit” 2005 Faqe 5-62, 216-246, 293-349.</p>	
<b>IV</b>	<b>Vlerësimi nxënësve</b>	
<b>A</b>	<b>Literatura:</b> Mita .N. “Vlerësimi i nxënësve” - Cikël leksionesh faqe 1-90.	
<b>B</b>	<b>Literatura :</b> grup autorësh “ Si të shkruajmë objektivat për mësimdhënien e vlerësimin” 2009	
	<p><b>Temat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësimi nxënësit</li> <li>Vlerësimi mësimdhënies</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Grup Autorësh “Metoda të mësimdhënies. (Manual për Mësuesit e rinj” 1999 Faqe 137 – 177 dhe 211 -223</p>	

V	<b>Menaxhimi klasës</b>	
A	<p><b>Temat :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhimi i klasës</li> <li>• Trajtimi diferencuar i nxënësve</li> </ul> <p><b>Literatur:</b> Tamo A. Karaj TH. Rapti E." Mësimdhënia e të nxënësit" 2005 Faqe 246- 293.</p>	
B	<p><b>Tema :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe drejtimi klasës</li> </ul> <p><b>Literatur:</b> Grup Autorësh "Metoda të mësimdhënieve Manual për mësuesit e rrinj" 1999 Faqe 118 -137</p>	
C.	<b>Literatur :</b> Karaj Th. " Menaxhimi Klasës" 2009	
<b>VI</b>	<b>Psikologjia e zhvillimit</b>	
	<b>Literature:</b> Karaj. Th. "Psikologjia e zhvillimit të fëmijës" 2005	

## PROGRAM I DREJTSHKRIMIT PËR PROVIMIN E SHTETIT NË MËSUESI

### I. DREJTSHKRIMI I ZANOREVE

1. Zanorja e e theksuar dhe e patheksuar
2. Zanorja ë e patheksuar
  - 2.1 ë-ja paratheksore
  - 2.2 ë-ja pastheksore
  - 2.3 ë-ja fundore
- 3 Zanorja **u, i** dhe **y, u** dhe **y.**
4. Grupe zanoresh dhe diftongje
  - 4.1 **ie** dhe **je**
  - 4.2 **ye**
  - 4.3 **ua, ue**
- 5 Apostrofi

### II. DREJTSHKRIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

1. Bashtingëlloret e zëshme në fund dhe në trup të fjalës
2. Bashkëtingëlloret nistore **sh, zh, c, s, z**
3. Bashkëtingëllorja **j**
4. Bashkëtingëllorja **h**
5. Bashkëtingëllorja **rr**
6. Bashkëtingëllorja **nj** në trup dhe në fund të fjalës
7. Grupe bashkëtingëllorësh (**mb, nd, ng, ngj**)
8. Takime bashkëtingëllorësh
  - 8.1 Takimi i **t**-së me **sh**-në
  - 8.2 Takimi i **g**-së ose i **n**-së me **j**-në
  - 8.3 Takimi i **d**-së, **s**-së, **t**-së ose i **z**-së me **h**-në
  - 8.4 Takimi i **d**-së me **t**-në

### **III. DREJTSHKRIMI I DISA FJALËVE TË HUAJA DHE I EMRAVE TË PËRVEÇËM TË HUAJ**

1. Fjalët që kanë **-ia, ie, io, iu** me **i** të patheksuar në trup të tyre
2. Fjalët me burim nga latinishtja a nga gjuhët romane, si edhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një **c** të ndjekur nga zanorja **e** ose **i**
3. Emrat e huaj të përveçëm

### **IV. ÇËSHTJE GRAMATIKORE**

1. Drejtshkrimi i disa trajtave të shumësit të emrave dhe të mbiemrave
- 1.1 Emrat femërorë me **-ë**
- 1.2 Emrat dhe mbiemrat mashkullorë me **-al, -an, -ar, -ec, -el, -er, -et, -ez, -ii, -ir, -al, -on, -oz, -un**
2. Drejtshkrimi i nyjës së përparme
3. Drejtshkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes

### **V. PËRDORIMI I SHKRONJAVE TË MËDHA**

1. Tek emrat dhe mbiemrat e personave, epitetet ose ofiqet (nofkat) që janë pjesë përbërëse e tyre, si edhe tek pseudonimet.
2. Tek emërtimet e funksioneve shtetërore, politike e ushtarake, të gradave, të titujve fetarë etj.
3. Tek emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore më të larta, titujt më të lartë të nderit në RSH dhe tek emërtimet e urdhreve e të medaljeve shtetërore.
4. Tek emrat e përvecëm të botës mitologjike e fetare, si edhe tek ato të figurave e të tregimeve popullore
5. Tek emërtimet gjografike e territoriale-administrative si edhe tek emrat e tjerë të vendeve
6. Tek emërtimet e periudhave, të ngjarjeve, të akteve e të dokumenteve historike me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare, të monumenteve historike e të monumenteve të kultures
7. Tek emërtimet zyrtare(të sotme ose historike) të institucioneve të shtetit e të partive, si edhe tek emërtimet e organizatave shoqërore e të njësive ushtarake kryesore.
8. Tek emërtimet e festave kombëtare dhe ndërkombëtare
9. Tek titujt e gazetave, të revistave e të librave.

### **LITERATURA**

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973
2. Gjuha letrare për të gjithë, Tiranë, 1976
3. Rami Memushaj, Shqipja standard. Si ta flasim dhe ta shkruajmë?